



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

**RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN (ANËTARËSIMIN) E PROFESIONISTËVE
TË OIK**

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË INFIERMIEREVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 15, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me _____, nxjerr këtë

**RREGULLORE PËR
REGJISTRIMIN (ANËTARËSIMIN) E PROFESIONISTËVE TË OIK**

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kriteret e regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve të OIK. Po ashtu përcaktohen kushtet e menaxhimit të regjistrave përkatës në të cilët mbahet evidenca e të gjithë profesionistëve të OIK që janë anëtarë të OIK

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Kjo rregullore zbatohet për procedurat e regjistrimit të profesionistëve të OIK.
2. Kjo rregullore përfshinë dispozita edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me procesin e regjistrimit të profesionistëve të OIK.
3. Kjo rregullore nuk zbatohet për procedurat e regjistrimit të profesionistëve të OIK me shtetësi të huaj.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Termet dhe akronimet të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Anëtarë** - nënkupton infermierët, mamitë dhe të gjitha profesionistët e tjerë shëndetësorë pjesë e OIK
 - 1.2 **Regjistri** – nënkupton Regjistrat e anëtarëve të OIK,
 - 1.3 **Oda** – nënkupton Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës,
 - 1.4 **MSh** – nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

KAPITULLI II –REGJISTRIM, LICENCIM DHE RILICENCIM

Neni 4

Kompetencat dhe përgjegjësitë

1. Zyra administrative e Odës ka këto kompetenca dhe përgjegjësi për profesionistët përkatës të Odës :
 1. Mbikëqyrin procesin e regjistrimit dhe anëtarësimit të anëtarëve të Odës;
 2. Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e bazës e të dhënave përkitazi me regjistrin e profesionistëve të Odës te anëtarësuar;
 3. Vendosjen në shkallë të parë mbi përmbushjen e kushteve për anëtarësim;
 4. Lëshimin e ID Kartelave/Certifikata të anëtarëve;
2. Zyrës administrative si përgjegjëse për anëtarësim, mund t'i barten edhe përgjegjësitë të tjera nga organet e Odës përshtatshëmrisht me natyrën e funksioneve themelore të parapara me këtë nen.

KAPITULLI III REGJISTRIMI (anëtarësimi) I PROFESIONISTËVE TË Odës

Neni 5

Regjistri i anëtarëve

1. Të gjithë profesionistët e OIK që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale dhe të gjithë profesionistët e OIK që kryejnë veprimtari të tjera nga veprimtaria shëndetësore në Republikën e Kosovës, janë të obliguar që të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odë.
2. Zyra administrative e Odës është kompetente të bëjë regjistrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të profesionistëve të Odës që anëtarësohen. Regjistri i anëtarëve përmbanë së paku këto të dhëna:
 - a. Nr. rendorë
 - b. Emri dhe Mbiemrin
 - c. Nr. e Licencës (nëse ka)
 - d. Datën e regjistrimit
 - e. Profili
3. Zyra administrative me rastin e regjistrimit të anëtarit të Odës, vlerësonë përmbushjen e kushteve të përcaktuar me këtë rregullore për fitimin e statusit të anëtarit të Odës.
4. Vetëm pas verifikimit të plotësisimit të kushteve nga ana e Zyrës, parashtruesi i kërkesës për anëtarësim regjistrohet në regjistrin e anëtarëve të Odës, që përndryshe përbën regjistrin e profesionistëve të lëmive të profesionistëve të Odës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës.
5. Regjistri i anëtarësisë do të jetë publik në faqen zyrtare të Odës.
6. Në rastet të paqartësisë mbi përmbushjen e kriterëve për anëtarësim, zyra administrative mund të kërkojë opinion nga Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 6

Procedura e regjistrimit (anëtarësimi)

1. Procedura e regjistrimit (anëtarësimi) iniciohet me dorëzimin e kërkesës për anëtarësim në Odë, të cilin e plotëson personalisht profesionistit i Odës i cili ka për detyrim ligjor anëtarësimin në Odë, nëpërmes platformës elektronike të OIK
2. Kërkesa për anëtarësim do të përmbajë të paktën të dhënat personale si në vijim:
 - 2.1 Emri, emri i prindit dhe mbiemri;
 - 2.2 Data dhe vendi i lindjes;
 - 2.3 Numri personal i letërnjoftimit;
 - 2.4 Shtetësia;
 - 2.5 Emri dhe adresa e institucionit ku ushtrohet veprimtaria;
 - 2.6 Statusi profesional
 - 2.7 Numri i licencës, nëse posedon?
 - 2.8 Statusi akademik;?
 - 2.9 Adresa aktuale;
 - 2.10 Të dhënat mbi komunikim, që përfshijnë numrin e telefonit dhe adresa e postës elektronike.
 - 2.11 Deklarata nën betim;
 - 2.12 Nënshkrimi, data e aplikimit.
3. Në procesin e aplikimit për anëtarësim, aplikuesi duhet t'i bashkëngjit të paktën këto dokumentet si në vijim: (përshtatja me dokumentet e kërkuara në platformë)
 - 3.1 Fotografia;
 - 3.2 Kopja e letërnjoftimit valid;
 - 3.3 Ekstrakti i lincjes;
 - 3.4 Kopja e noterizuar e diplomës së studimeve dhe dëshmi të tjera të cilat vërtetojnë aftësimin në profilin specifik (nëse ka);
 - 3.5 Kopja e licencës, në rast se e posedon;(nëse licenca ka afat)
 - 3.6 Kopja e vendimit të thirrjes akademike e lëshuar nga organi kompetent (nëse ka thirrje akademike); dhe
 - 3.7 Dëshmia e pagesës për taksën administrative për anëtarësim.
4. Të dhënat personale nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni do përpunohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Anëtarët e Odës janë të obliguar që çdo ndryshim i të dhënave personale dhe statusit profesional në institucion publik apo privat, ta raportoj Odës, më së largu 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga ndryshimi.

Neni 7

Anëtarësimi i profesionistëve të Odës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë Republikës së Kosovës

1. Profesionistët e OIK me shtetësi të Republikës së Kosovës të cilët ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe që shprehin vullnetin të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odë, mund të paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim në pajtim me kushtet siç janë paraparë me dispozitat e këtij neni përkitazi me regjistrimin dhe anëtarësimin e mjekëve vendor.
2. Procedura e regjistrimit dhe anëtarësimit do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 6, 7 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Anëtarësimi i shtetasit jo kosovar

1. Profesionisti i OIK që ka shtetësi të huaj dhe që dëshiron të ushtrojë veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Kosovës, është i obliguar që të anëtarësohet në Odë.
2. Anëtarësimi i profesionistit jo kosovar përfshin të gjitha dispozitat të cilat zbatohen te anëtarësimi i profesionistit kosovar duke përfshirë dhe kushtet shtesë si:
 - a. Leja e qëndrimit me afat në Republikën e Kosovës, e noterizuar në pajtim me ligjet në fuqi;
 - b. Licenca e punës nga vendi origjinës;
 - c. Vërtetimi nga odat përkatëse nga shteti shtetësinë e të cili e ka aplikuesi;

Neni 9

Procedura e vendimmarrjes për regjistrim dhe anëtarësim

1. Oda me rastin e pranimit të formularit për regjistrim, parashtruesit i lëshon një vërtetim/konfirmim me të cilin dëshmohet dorëzimi i formularit për regjistrim dhe anëtarësim në Odë.
2. Pas pranimit të dokumentacionit sipas paragrafit 1 të këtij neni, zyra administrative do të shqyrtojë dosjen e tij dhe për regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit mund të vendosë ta:
 - 2.1 Aprovoj regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit duke lëshuar ID Kartelën/certifikatën e anëtarësim si dëshmi për anëtarësim pa pasur nevojë për vendim të veçantë;
 - 2.2 Refuzoj regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj rregulloreje përmes vendimit me shkrim mbi arsyet e refuzimit të regjistrimit;

3. Zyra administrative mundet që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për regjistrim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit.
4. Zyra Administrative për regjistrim do të konsultojë Këshillin Etik lidhur me evidencën e masave disiplinore për vërtetimin e faktit lidhur me zbatimin e masës disiplinore të heqjes nga regjistri të profesionistit të Odës ndaj të cilit është shqiptuar masa e tillë disiplinore.
5. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të zyrës për regjistrim anëtarësim sipas paragrafit 2, të këtij neni, mund të parashtrorë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimin të vendimit.

Neni 10 **Kartela e anëtarësisë**

1. Me rastin e regjistrimit, të anëtarësuarit i lëshohet kartela identifikuese e anëtarësisë në të cilën shënohet të paktën këto të dhëna:
 - 1.1 Emri dhe Mbiemri;
 - 1.2 Data e lëshimit;
 - 1.3 Numri rendor i anëtarësisë;
 - 1.4 Fotografia;
 - 1.5 QR Codi;
 - 1.6 Të dhëna tjera të cilat mund të kërkohen nga Këshilli Drejtues.
2. Përdorimi, humbja apo dëmtimi i kartelës do të trajtohen përshtatshëm sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
3. Kartela e anëtarësisë është pronë e Odës dhe si e tillë duhet t'u dorëzohet organeve kompetente të Odës me rastin e skadimit të saj apo në rast të çregjistrimit të profesionistit të OIK nga Regjistri i anëtarësisë.
4. Mos përmbajtja e këtij detyrimi, ka për pasojë iniciimin e procedurës disiplinore në organet etike për shkeljet e detyrimeve ligjore.

Neni 11 **Pagesa e anëtarësisë**

1. Anëtarët e Odës kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, sipas vendimit mbi lartësinë e taksave administrative të Odës të nxjerrur nga Kuvendi.
2. Nëse një anëtar i Odës nuk paguan tarifën e anëtarësisë brenda gjashtë muajve nga marrja e njoftimit, shërbimi profesional merr një vendim që përcakton përfundimin e anëtarësimin

në Odë, fshihet nga Regjistri për regjistrimin e anëtarëve të Odës dhe humbet të gjitha të drejtat që rrjedhin nga anëtarësimi i tij në Odë, përfshirë e drejta për licencë.

3. Një anëtar i Odës që humbet statusin e anëtarit, në përputhje me dispozitat e paragrafit paraprak, në rast të paraqitjes së një kërkesë për anëtarësim në Odë, është i detyruar të paguajë dyfishin e tarifës për regjistrim në Regjistër, të përcaktuar me vendim mbi lartësinë e taksave administrative të Odës të nxjerrur nga Kuvendi.

Neni 12

Çregjistrimi nga anëtarësia

1. Çregjistrimi nga anëtarësia e Odës bëhet në rastet kur:
 - 1.1 Anëtari paraqet një kërkesë me shkrim për çregjistrim të anëtarësisë nga Oda, ku paraqet shkaqet përse kërkon të çregjistrohet,
 - 1.2 Anëtari është dënuar me vendim të formës së prerë nga organet e drejtësisë lidhur me vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo kundër shëndetit publik, që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të profileve të OIK,
 - 1.3 Mos përmbushjeve të detyrimeve për pagesën e taksës së anëtarësisë,
 - 1.4 Ekzekutimin e masave disiplinore të plotfuqishme të shqiptuara nga organet etike të OIK,
 - 1.5 Në rastet e tjera të parashikuara nga ligjet në fuqi.
2. Çregjistrimi nga Regjistri i Anëtarësisë nënkupton edhe heqjes dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së profesionistëve të Odës.
3. Zyra administrative për Regjistrim pas shqyrtimit të kërkesës për çregjistrim nxjerrin Vendim për parashtruesin në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës.
4. Në regjistrin e anëtarësisë së Odës bëhet shënimi lidhur me çregjistrimin e anëtarit dhe arsyet e këtij çregjistrimi.
5. Anëtarët që janë çregjistruar si anëtarë të Odës komfor me nën paragrafin 1.1 të paragrafit 1, të këtij neni, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për ri regjistrim, pasi të plotësojnë edhe një herë të gjitha procedurat për regjistrimin fillestar.

Neni 13

Taksa administrative

1. Taksa administrative për regjistrim caktohet me rregullore për caktimin e lartësisë së taksave administrative, e miratuar nga Kuvendi.
2. Taksa administrative për regjistrim caktohet për periudhën 5 vjeçare.

KAPITULLI IV – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14 Hyrja në fuqi

1. Kërkesat për procedurat e Regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të anëtarëve të pranuar në Odë para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të zgjidhen në përputhje me rregulloren sipas së cilës është nisur procedura. Përgjashtimisht dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nëse janë më të favorshme për anëtarët
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen aktet tjera ligjore të Odës të cilat janë në kundërshtim me të.
3. Çështjet nga fushë veprimtaria e zyrës administrative për Regjistrim e anëtarëve të OIK, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, procedohen në KD, deri në plotësim-ndryshimin e saj.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditën pas miratimit të saj nga Kuvendi i Odës.

Prishtinë, 2024